

VENDIM
Nr.561, datë 11.8.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.432, DATË 13.7.2007
“PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE, TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI
PAGË PËR PUNONJËSIT NË SHËRBIMIN INFORMATIV TË SHETIT”, I
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24. 3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të neneve 8 e 22 të ligjit nr.9357, datë 17.3.2005 “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr 432, datë 13.7.2007 bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr.2 “Struktura dhe nivelet e pagave, sipas klasifikimit të funksioneve, për punonjësit në Shërbimin Informativ të Shtetit”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Pika 8 shfuqizohet.

2. Efektet financiare, për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për rritjen e pagave, për vitin 2011.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha